

Çabej Nurkollar

THEMELIMI I PARTIVE POLITIKE DHE ROLI I TYRE NË SHTET NDËRTIMIN E KOSOVËS

ABSTRAKTI

Në një demokraci ideale shumëpartiake, partitë politike janë mekanizmat kryesorë që e bëjnë të funksionojë zinxhirin demokratik të delegimit politik dhe llogaridhënies. Partitë politike përmbushin një rol të ndërmjetëm jetik midis qytetarëve dhe shtetit, në të cilin supozohet se përfaqësojnë interesat e qytetarëve dhe i përkthejnë këto në një agjendë politike që i përgjigjet shqetësimeve të qytetarëve.

Në një demokraci parlamentare si Kosova, një parti politike bashkon njerëz me të njëjtat ide politike. Duke marrë pjesë në zgjedhje, partitë synojnë të marrin sa më shumë vota në mënyrë që të kenë sa më shumë anëtarë të tyre në organet përfaqësuese, si në parlament ose në Kuvendet komunale.

Partitë politike kanë funksione të ndryshme. Njëra është promovimi i interesave të votuesve të tyre. Ata gjithashtu hartojnë programe partie. Qytetarët mund të bashkohen me partitë politike, duke u mundësuar atyre që të ndihmojnë në formësimin e programit të partisë.

Sipas rregullorës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, çdokush në Kosovë mund të themelojë një parti politike. Partitë politike në Kosovë regjistrohen në Komisionin Qendror Zgjedhor, në bazë të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, ligji nr. 03/L-073.

Ky punim, ofron një analizë të detajuar rreth praktikave në partitë politike në Kosovë. Këtu është shqyrtuar funksionimi i brendshëm i parive politike, duke analizuar statutin dhe institucionet partiake, rolin e liderit. Partitë e përfshira në këtë punim janë: LDK, PDK, “Lëvizja VETËVENDOSJE!”, AAK.

Fjalët kyçe: **partitë politike, roli, shtetndërtimi i Kosovës**